



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASENIT LUMOR DRIN-BUNË

Nr 26 prot. Dt 08/07/2025

VENDIM

Nr. 20, datë 08.07.2025

PËR

**SHTYERJEN PËR NJË SHQYRTIM TË MËVONSHËM TË KËRKESËS
PËR AUTORIZIM PËR PËRDORIM BURIMI UJOR PËR NDËRTIMIN,
RINDËRTIMIN, APO SHEMBJEN PËR MBROJTJEN E BRIGJEVE,
MUREVE, PRITAVE E VEPRAVE TË TJERA NË BRIGJE, ME
VENDNDODHJE LUMI DRIN, BASHKIA VAU-DEJËS TË SUBJEKTIT
BASHKIA VAU-DEJËS**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 141, të ligjit nr.29/2024, “Për Burimet Ujore”, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.550, datë 15.07.2020, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Basenit Lumor Drin-Bunë,

V E N D O S I:

1. Shtyerjen për një shqyrtim të mëvonshëm të kërkesës “Për autorizim për përdorim burimi ujor për ndërtimin, rindërtimin, apo shembjen për mbrojtjen e brigjeve, mureve, pritave e veprave të tjera në brigje”, të subjektit Bashkia Vau Dejës, me vendndodhje lumi Drin, Bashkia Vau Dejës, me arsyetimin që Bashkia Vau Dejës duhet të rrakordojë me Bashkinë Shkodër për ndërtimin e strukturave (argjinaturave) në këtë segment të Lumit Drin pasi ky lum në segmentin e propozuar është kufiri administrativ i këtyre dy bashkive.

2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Emri i trupit ujor: Lumi Drin.

Koordinatat e konturit të mbrojtjes lumore (KRGJSH)

1.	X=466825;	Y=4651985;	Z=20.23
2.	X=466667;	Y=4652188;	Z=21.20
3.	X=466880;	Y=4652362;	Z=27.37
4.	X=466790;	Y=4651955;	Z=20.12
5.	X=466600;	Y=4652157;	Z=20.85
6.	X=465998;	Y=4651771;	Z=19.74
7.	X=465064;	Y=4651230;	Z=19.72
8.	X=464149;	Y=4651523;	Z=19.44
9.	X=464350;	Y=4652039;	Z=17.70
10.	X=464258;	Y=4652323;	Z=17.39
11.	X=463484;	Y=4652815;	Z=16.49
12.	X=462998;	Y=4653058;	Z=18.79

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektiv.

KRYETARI I KBL DRIN-BUNË

MAJLINDA ANGONI

